



HEKURUDHA

Hekurudhat e Kosovës

REVISTA PERIODIKE E HEKURUDHAVE TË KOSOVËS Sh.A. Nr.II

SHTATOR 2010

EDITORIAL:

KAH PO SHKOJNË HEKURUDHAT E KOSOVËS
Xhevat Ramosaj Kryeshef Ekzekutiv i HK-së

fq. 4,5

TAKIMI I KRYESHEFIT EKZEKUTIV TË HEKURUD-
HAVE TË KOSOVËS ME KLIENTËT E TRANSPORTIT

fq. 10

PËRFAQËSUESIT E HEKURUDHAVE TË KOSOVËS LOBOJNË NË
HEKURUDHAT E FRANCËS PËR ANËTARËSIMIN E TYRE NË
UIC (UNIONI NDËRKOMBETAR I HEKURUDHAVE)

fq. 13



HEKURUDHA ËSHTË PRIORITET I IMI
Intervistë me z. Fatmir Limaj – Ministër i Transportit
dhe Postë-Telekomunikacionit fq. 6



REPORTAZH: FERONIKELI, KLIENT KYQ I HEKURUDHAVE TË KOSOVËS

fq. 14




Shijone natyrën duke udhëtuar


 Hekurudhat e Kosovës Sh.A
 Kosovske Železnice D.D
 Kosovo Railways J.S.C

info: 038 536 758
www.kosovorailway.com



Që mallrat-tuaja të jenë të sigurt


 Hekurudhat e Kosovës Sh.A
 Kosovske Železnice D.D
 Kosovo Railways J.S.C

info: 038 536 758
marketing@kosovorailway.com



BOTUES

HEKURUDHAT E KOSOVËS SH.A.

KRYEREDAKTOR
REFET ÇITAKU

Zv. KRYEREDAKTOR
ARBESA MJEKU

REDAKSIA

ZEJNULLAH BERISHA

BLERTA KRASNIQI

FITIM KAJTAZI

ALI JUSAJ

ADRESA:

Sheshi i Lirisë p.n
Fushë Kosovë
Tel: +381 (0) 38 550 550 550
Fax: (0) 038 550 550 177
info@kosovarailway.com
www.kosovorail.com

Dizajni dhe Printimi:
EUROPRINTY

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA.....	3
KAH PO SHKOJNË HEKURUDHAT E KOSOVËS.....	4-5
HEKURUDHA ËSHTË PRIORITET I IMI.....	6
IMPLEMENTIMI I PROJEKTEVE KAPITALE KËNAQ TË PRITURAT.....	7-8
NE DHE NDARJA E KOMPANISË.....	9
TAKIMI I KRYESHEFIT EKZEKUTIV TË HEKURUDHAVE TË KOSOVËS ME KLIENTËT E TRANSPORTIT.....	10
TAKIMI I KRYESHEFIT EKZEKUTIV TË HEKURUDHAVE TË KOSOVËS ME KLIENTËT E TRANSPORTIT.....	11
PLANI I VEPRIMIT PËR NGRITJEN E SIGURISË NË HEKURUDHAT E KOSOVËS.....	12
PËRFAQËSUESIT E HEKURUDHAVE TË KOSOVËS LOBOJNË NË HEKURUDHAT E FRANCËS PËR ANËTARËSIMIN E TYRE NË UIC (INTERNATIONAL UNION OF RAIL- WAYS).....	13
NEWCO FERONICEL NË DRENAS JLIENT KYQ I HEKURUDHAVE TE KOSOVËS...	14
HISTORIKU I STACIONIT HEKURUDHOR TË DRENASIT.....	15
HISTORIKU DHE RËNDESIDIA E OPERIMIT ME TRENA.....	16
MBAHET TRAJNIMI ME PUNËTORET E HK-SË.....	17
OPINIONE.....	18
HEKURUDHAT E KOSOVËS MENDOJNË EDHE PËR TË MITURIT.....	19
HEKURUDHAT E KOSOVËS SËRISH PERKRAHIN HANDIKOS-in.....	20
AKTIVITETET SPORTIVE FRESKIM PËR PUNËTORET E HK së.....	21
TABELA/REZULTATET.....	22



KAH PO SHKOJNË HEKURUDHAT E KOSOVËS

Pakë histori - Që në kohët më të lashta, mendimi krijues i njeriut është përpjekur të zgjidh nevojat për lëvizje dhe bartje, të cilat kanë përfaqësuar gjithnjë kërkesat më jetësore të shoqërisë njerëzore. Për këtë "ai" ka shfrytëzuar zhvendosjen me shtytje në dëborë dhe akull, hedhjen, pjerrtësinë, ujin, rrokullisjen dhe së fundi rrotat. Vija më e vjetër hekurudhore konsiderohet

kur bëhet fjalë për hekurudhën ata mendojnë se hekurudha përbëhet nga binarët nëpër të cilët qarkullon një lokomotivë me disa vagonë. Në fakt kjo është krejt ndryshe dhe hekurudha paraqet një sistem në vete i cili është mjaft kompleksiv. Thënë më shkurt, në kohën më të re hekurudha në shumicën e vendeve të Evropës dhe botës po merr gjithnjë e më shumë prioritet qoftë në transportin

miqve tanë e rifilluam procesin e punës dhe rimëkëmbjen e hekurudhës sonë. Nuk ishte e lehtë dhe në rrugën tonë kishim shumë sfida të cilat ne i tejkaluam me sukses dhe sot jemi në një situatë krejtësisht ndryshe nga viti i pasluftës. Sot, marrim frymë më lehtë, por ne nuk mund të jemi të kënaqur, sepse ka aq shumë për tu bërë... E kaluara dihet, dihet edhe e sotmja, por cili është drejtimi ynë për të nesërmen. Kjo është tema për të cilën dëshiroj t'i informoj lexuesit e nderuar.

Ku do jemi nesër – Republika e Kosovës i ka përcaktuar qartë synimet e veta drejt integritimit në Bashkimin Evropian. Ministria e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit po ashtu i ka përcaktuar politikat dhe strategjitë zhvillimore të fushave të cilat i mbulon; ndër to edhe të sektorit hekurudhor. Pra, synimi i kësaj ministrie dhe në radhë të parë edhe i Hekurudhave të Kosovës është që sistemi hekurudhor i Kosovës të jetë pjesë e Rrjetit të Integruar Hekurudhor Evropian.

Që kjo të arrihet, nuk është e lehtë dhe nevojitet një punë e madhe. Mirëpo ne nuk kemi ndenjur duarkryq. Angazhimet tona në tri katër vitet e kaluara kanë qenë shumë të mëdha. Pjesëmarrja jonë në Grupin Punues mbi Hekurudhat dhe Interoperabilitetin të Observatorit të Transportit për Evropën Jug lindore (SEETO), që nga viti 2006 e deri më sot, ka ndikuar që të zhvillohen shumë procese pozitive.

Unë do të përmendi në mënyrë kronologjike aktivitetet më të rëndësishme të kohëve të fundit të cilat kanë ndodhur dhe të cilat janë në vazhde e sipër:

- Në nëntor të viti 2009 Qeveria e Kosovës ka miratuar Strategjinë Zhvillimore e Transportit Multi Modal, pjesë e së cilës është edhe sektori hekurudhor dhe zhvillimet e këtij sektori deri në vitin 2030
- Në shkurt të këtij viti, Parlamenti i Kosovës e ka miratuar listën e Bordit të Drejtorëve të Autoritetit Rregullativ Hekurudhor i cili autoritet është në themelim e sipër dhe do të merret me rregullimin e sektorit hekurudhor në Kosovë
- Në shkurt të këtij viti, Qeveria e Kosovës ka sjellë vendimin mbi ndarjen e Hekurudhave të Kosovës në dy kompani të reja:
- Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës ShA (INFRAKOS); dhe
- Operimin me Trena të Hekurudhave të Kosovës ShA (TRAINKOS)
- Në prill të këtij viti ka filluar studimi i fizibilitetit për modernizimin e Linjës së 10 hekurudhore (Leshak- Mitrovicë-Fushë Kosovë-Ferizaj-Hani i Elezit)
- Është përgatitur marrëveshja konform standardeve të BE-së për kalimet hekurudhore kufitare me Maqedoninë; dhe
- Ministria e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit ka themeluar grupin punues



Xhevat Ramosaj
Kryeshef Ekzekutiv i HK-së

ajo e transportit të mineraleve në Tirol të Austrisë e ndërtuar në vitin 1530.

Vija e parë hekurudhore në Kosovë është ndërtuar në vitin 1874 në relacionin Hani i Elezit – Fushë Kosovë – Mitrovicë. Në vitin 1931 kjo linjë është vazhduar në relacionin Mitrovicë – Leshak, më 1934 ajo Fushë Kosovë – Prishtinë, më 1936 Fushë Kosovë – Pejë, më 1949 Prishtinë – Podujevë – Livadhi dhe më 1963 Klinë – Prizren.

Çka është hekurudha - Për shumë qytetarë,

e udhëtarëve ashtu edhe në atë të mallrave. Prandaj, BE-ja ka një interesim të veçantë që të zhvilloj këtë sektor shumë të rëndësishëm, përparësitë e të cilat janë të pakrahueshme me sektorin rrugor apo ajror. Kjo për shkak të ruajtjes së infrastrukturës rrugore, ambientit, ikjes nga tollovitë dhe aksidentet në rrugë, mundësive për transporte masive të të gjitha llojeve të mallrave dhe mundësisë ideale për zhvillimin e transportit multi modal.

Ku jemi sot – E nisëm nga zeroja në vitin 1999, dhamë djersën dhe mundin tonë dhe falë



për hartimin e ligjit të ri mbi hekurudhat. Unë me këtë rast do të ndalem në çështjen e cila ka të bëjë me ndarjen e Hekurudhave të Kosovës ShA. Ky proces i rëndësishëm për sektorin hekurudhor tanimë ka filluar të zbatohet dhe pritet të kryhet deri në fund të këtij viti. Janë formuar grupet punuese të ekspertëve të cilat po punojnë në procesin e ndarjes. Ne jemi të vetëdijshëm se ky nuk do të jetë një proces i lehtë, andaj edhe ekziston një përkushtim i madh i të gjithëve që kjo të

hor. Me këtë do të mundësohet futja e operatorëve të rinj në tregun hekurudhor dhe njëkohësisht do të rritet dukshëm mundësia e investimeve në këtë sektor. Kjo ndarje do t'i përcaktojë shumë qartë përgjegjësitë dhe fushëveprimin e dy kompanive të reja, e tëra kjo në drejtim të zhvillimit të këtij sektori shumë të rëndësishëm për vendin.

Është me rëndësi të ceket se Qeveria e Kosovës pas ndarjes do të ketë mundësinë që të bënë privatizimin e operimit me trena,

korridori është që Kosova të ofron kushte më të mira për transportin hekurudhor, por edhe atë rrugor. Ne hekurudharët jemi të vetëdijshëm për këtë, MTPT-ja dhe MEF-i po ashtu; andaj edhe kemi ndërmarrë veprimet e duhura që të jemi të përgatitur për të nesërmen më të mirë.

Në fund duhet të ceket se me ndarjen e Hekurudhave të Kosovës nuk do të pëson asnjë punonjës por vetëm se do të shtohet numri i të punësuarve. Ndarja do të jetë një sfidë e

RRJETI HEKURUDHOR I KOSOVËS



kryhet me sukses.

Komisioni Evropian qëndron përkrah institucioneve tona që të ndihmojë me asistencën e vet në këtë proces të rëndësishëm. Kërkesat e KE-së kanë qenë dhe mbeten shumë të qarta, që edhe Kosova duhet t'i ketë të ndarë këta dy sektorë, në mënyrë që të mundësohet një qasje e lirë, jodiskriminuese, fer dhe korrekte në tregun e transportit hekurud-

të dhënies me koncesion, apo të gjetjes së ndonjë mundësie tjetër të partneritetit publiko privat të investimeve drejt zhvillimit të këtij sektori.

Duke ditur se Komisioni Evropian i ka përcaktuar korridoret kryesore të transportit rrugor dhe hekurudhor. Duke ditur se korridori i dhjetë pan-evropian e anashkalon Kosovën; e vetmja mënyrë e konkurrencës karshi këtij

cila do të kalohet me sukses dhe unë besoj se Hekurudhat e Kosovës do të kenë një ardhmëri shumë më të mirë drejt integritit në Hapësirën Unike të Transportit Hekurudhor Evropian.

**Kryeshefi Ekzekutiv
Xhevat Ramosaj**

HEKURUDHA ËSHTË PRIORITET I IMI



Me ministrin Limaj është kënaqësi të bisedosh, kjo për arsye se ministri Limaj ka shprehur një vizion të qartë të ndërtimit të infrastrukturës rrugore dhe një vizion po ashtu të qartë për zhvillimin e sektorit hekurudhor. Dhe dihet se me rrugë dhe hekurudha lidhen vendet, lidhen fatet dhe lidhet ardhmëria...

•Hekurudha: Z. Ministër, ju keni punuar shumë dhe jeni duke punuar shumë në ndërtimin e rrugëve. Neve si hekurudharë nuk na intereson shumë rruga. Jeta e jonë lidhet me hekurudhën, andaj na tregoni ju lutem se çka keni bërë ju për Hekurudhat e Kosovës?

z. Limaj: Është e vërtetë se Kosova ka nevojë të mëdha dhe se i mungon një infrastrukturë e mirëfilltë në të gjitha drejtimet. Mirëpo, prioriteti im ka qenë dhe mbetet ndërtimi i domosdoshëm i infrastrukturës rrugore në mënyrë që Kosova të jetë pjesë e vendeve të zhvilluara nëpër të cilën do të mundësohet qarkullimi i lirë i njerëzve dhe mallrave. Prandaj, përveç korridoreve të filluara, tanimë kemi filluar edhe zbatimin e projektit të ndërtimit të "Rrugës së Kombit", projekt ky i cili është me rëndësi jetike jo vetëm për Kosovën por edhe për rajonin e gjerë. Mirëpo, unë në politikën e mia zhvillimore nuk e kam lënë anash as sektorin hekurudhor duke u kujdesur kështu për zbatimin e një mori projekteve të ndryshme, rezultatet e të cilave pritet të bëhen të dukshme në të ardhmen e afërt.

Hekurudha: për cilat projekte bëhe fjalë?

z. Limaj: Bëhet fjalë këtu për shumë projekte të cilat janë të rëndësishme për sektorin hekurudhor. Në veçanti do të përmendja:

1. Hartimin dhe miratimin e ligjit mbi Hekurudhat në Republikën e Kosovës, ligj ky i miratuar në qershor të vitit 2008 e me të ci-

lin vendosen bazat e një sektori hekurudhor konform standardeve evropiane.

2. Ndarjen e Hekurudhave të Kosovës në dy kompani të reja:

•Infrastrukturën e Hekurudhave të Kosovës ShA (INFRAKOS); dhe

•Operimin me Trena në Hekurudhat e Kosovës ShA (TRAINKOS).

3. Themelimin e Autoritetit Rregullativ Hekurudhor (ARH) i cili tanimë ka filluar të funksionalizohet.

4. Hartimin dhe miratimin e Strategjisë Zhvillimore të Transportit Multi Modal (pjesë e të cilës strategji është edhe plani i veprimit dhe ai investiv për sektorin hekurudhor deri në vitin 2030.

5. Fillimi i studimit të fizibilitetit për modernizimin e Linjës së 10 hekurudhore (Leshak – Mitrovicë – Fushë Kosovë – Ferizaj – Hani i Elezit)

6. Vazhdimi i investimeve për modernizimin e kësaj linje hekurudhore

7. Fillimi i hartimit të Ligjit të përgjithshëm mbi hekurudhat, ligj ky i cili do të jetë një ligj modern dhe gjithëpërfshirës sa i përket sektorit hekurudhor;

8. Përkrahja e Hekurudhave të Kosovës për anëtarësim në institucionet hekurudhore ndërkombëtare;

9. Angazhimi i vazhdueshëm në grupet punuese të SEETO-së në kuadër të Komisionit Evropian; dhe

10. Projekte dhe angazhime tjera të cilat do ta zhvillojnë edhe më tej sektorin hekurudhor në Kosovë.

Hekurudha: Ju lutem, na thoni se çka përfshihet me zhvillimin e projekteve të përmendura më lartë?

z. Limaj: S'ka dyshim se me secilin nga këto projekte do të përfiton sektori hekurudhor. Me ndarjen krijohet mundësia shumë më e madhe e tërheqjes së investimeve qoftë

në infrastrukturën hekurudhore, qoftë në operimin me trena; me ARH-në rregullohet sektori hekurudhor dhe mundësohet një mbikëqyrje më e mirë e këtij sektori; me studimin e fizibilitetit krijohet dokumenti bazë i cili do t'i tërheq investimet për modernizimin e kësaj linje hekurudhore; me strategjinë zhvillimore janë krijuar kushtet për zhvillimin e këtij sektori; ndërsa me angazhimet në SEETO janë krijuar mundësitë e integritetit të Hekurudhave të Kosovës në rrjetin e Integruar të Hekurudhave Evropiane gjë e cila pritet të ndodhë në një të ardhme të afërt.

z. Limaj: S'do mend se sektori hekurudhor është njëri ndër sektorët më të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik të vendit. Hekurudha mundëson transporte masive të mallrave dhe udhëtarëve. Me këtë ruhet ambienti, ruhet infrastruktura rrugore, zvogëlohet toll-ovia në rrugë dhe me këtë zvogëlohet edhe numri i aksidenteve. Pra, përparësitë e hekurudhave janë shumë të mëdha, andaj edhe interesimi i BE-së është që t'i jep prioritet zhvillimit të këtij sektori.

Dihet se investimet në hekurudhë kushtojnë shumë dhe ne nuk pretendojmë t'i arrijmë Hekurudhat Evropiane. Por qëllimi i jonë është që të gjejmë mundësitë e investimeve në këtë sektor në mënyrë që të modernizojmë linjat tona ekzistuese duke bërë kështu edhe elektrifikimin e tyre në mënyrë që Hekurudhat e Kosovës të jenë pjesë lidhëse e hekurudhave të rajonit me ato evropiane.

Ne do të shohim edhe mundësinë e privatizimit të operimit me trena, por edhe futjen e operatorëve të tjerë të brendshëm apo të jashtëm në mënyrë që të ketë një konkurrencë të mirëfilltë e cila do të ndikon pozitivisht në zhvillimin e mëtejshëm të këtij sektori.

Pra, përveç ndërtimit të një kornize të qëndrueshme ligjore dhe mundësive të integritetit, qëllimi i jonë është që të ndërtojmë edhe linja të reja aty ku është e mundur dhe e nevojshme, në mënyrë që të kemi një sistem të mirëfilltë hekurudhor i cili do t'i plotësonte në tërësi të gjitha kërkesat e qytetarëve të Kosovës për transportin e mallrave dhe atë të udhëtarëve.

Në kuadër të kësaj është edhe kërkesa e jonë ndaj komisionit evropian për studimin e fizibilitetit për linjën hekurudhore Prishtinë – aeroporti i Prishtinës, si dhe angazhimi i jonë për ndërtimin e linjës së ardhshme hekurudhore e cila do të lidhte Kosovën me Shqipërinë.

Hekurudha: Z. ministër, cila është porosia e juaj për hekurudharët?

z. Limaj: Të punohet shumë, secili të angazhohet për realizimin e detyrave të veta, në mënyrë që të zhvillohet një transport i sigurt dhe efikas i udhëtarëve dhe i mallrave. Unë premtoj se angazhimet e mia nuk do të mungojnë as në të ardhmen për përkrahjen e këtij sektori shumë të rëndësishëm.

Investimet kapitale ndikojnë në rritjen e dy parametrave kryesore, sigurisë dhe cilësisë në transportin hekurudhor, që pa dyshim janë bazë për një afarizëm të suksesshëm në Hekurudhat e Kosovës

IMPLEMENTIMI I PROJEKTEVE KAPITALE KËNAQ TË PRITURAT



Agron Thaqi

Anëtar i Bordit të Drejtorëve të HK-së

Misioni i Hekurudhave të Kosovës në esencë është të ofrojë shërbime të sigurta dhe cilësore në transportin e udhëtarëve dhe mallrave, brenda dhe jashtë vendit, nëpërmjet infrastrukturës hekurudhore. Me këtë hekurudhat synojnë mbështetjen e ekonomisë së vendit dhe cilësisë së jetës së qytetarëve.

Ky mision ushqehet nga mbështetja e vazhdueshme dhe prioritetet zhvillimore që ka vendosë aksionari, respektivisht Qeveria e Republikës së Kosovës, në kuadër të politikave zhvillimore për zhvillimin dhe modernizimin e infrastrukturës në tërësi. Por edhe nga prioriteti për plotësimin e kërkesave në kuadër të integritetit të gjithëmbarshtëm të Kosovës në Bashkimin Evropian. Kjo është përcaktuar edhe në dokumentin strategjik "Strategjia e Transportit Multimodal" dokument i miratuar nga Qeveria.

Dihet se Hekurudhat e Kosovës në periudhën e administrimit dhe menaxhimit të paraluftës dhe gjatë saj kanë pasur fatin sikurse edhe vetë ekonomia e Kosovës, nuk janë menaxhuar në mënyrë të drejtë, por janë eksploatuar dhe dëmtuar në një masë të madhe.

Sidomos ka munguar mirëmbajtja e domosdoshme, gjë që ka rezultuar me daljen nga funksionit të shumë kilometrave të binarëve hekurudhorë por edhe ka vënë në rrezik operimin në linjat tjera.

Po ashtu, një pjesë e madhe e mjeteve lëvizëse si lokomotiva, trena motorik dhe vagonë të udhëtarëve dhe mallrave janë shkatërruar ose bartur nga Kosova.

Andaj, përkundër gjithë këtyre problemeve Hekurudhat e Kosovës kanë bërë dhe po bëjnë një punë të mirë drejt konsolidimit dhe

zhvillimit të infrastrukturës hekurudhore në përgjithësi.

Një nga aktivitetet më të rëndësishme dhe më të kushtueshme në Hekurudhat e Kosovës janë pa dyshim investimet kapitale. Investimet kapitale ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejt në rritjen e dy parametrave kryesorë, sigurisë dhe cilësisë në transportin hekurudhor, që pa dyshim janë bazë për një afarizëm të suksesshëm të HK-së.

Duke e falënderuar Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit, Hekurudhat e Kosovës kanë arritur që për çdo vit nga buxheti i Kosovës të realizojnë investime kapitale në mirëmbajtje, rimodernizim, por edhe në projekte tjera. Duhet përmendur investimet kapitale mbi dy Mil Euro në rimodernizimin e lokomotivave, por edhe projektin e qendrës së kontrollit të trafikut-CTC, në vlerë tre MIL Euro. Hekurudhat kanë arritur të realizojnë investime të domosdoshme në vlerë më të vogël edhe nga buxheti i brendshëm.

Bordi i Drejtorëve të HK-së që me fillimin e punës ka kërkuar nga menaxhmenti marrjen e masave të shtuara në ngritjen në nivel sa më të lartë të sigurisë dhe cilësisë së transportit hekurudhor.

Ndërsa për të ngritur efikasitetin në vendim-marrje dhe mbikëqyrje në realizimin e këtyre parametrave Bordi ka formuar komitetet për siguri dhe projekte kapitale, të cilat kanë luajtur dhe po luajnë një rol shumë aktiv në mbështetjen dhe mbikëqyrjen e realizimit të këtyre dy parametrave, nëpërmjet rekomandimeve dhe sugjerimeve të dhëna për Bordin e Drejtorëve të Hekurudhave të Kosovës por edhe për menaxhmentin e kompanisë.

Me rekomandimin e komitetit për siguri ka filluar hartimi i dokumentit strategjik "Politika mbi sigurinë në Hekurudhat e Kosovës". Me këtë politikë synohet përcaktimi i drejtimeve kryesore, vendosja e masave adekuatë të sigurisë dhe zotimi i menaxhmentit dhe tërë stafit të Hekurudhave të Kosovës në plotësimin dhe respektimin e masave të sigurisë në hekurudha.

Në njërën anë kjo politikë do të mundësojë që të rishikohet e të rregullata e brendshme e kompanisë, të rifreskohet dhe të plotësohet me rregullativa dhe procedura të reja në përputhje të plotë me ligjet dhe standardet më të avancuara ndërkombëtare në fushën e sigurisë së transportit hekurudhor, siç janë standardet e UIC, etj. Ndërsa, në anën tjetër do të mundësojë planifikimin më të mirë të burimeve të nevojshme njerëzore, ngritjen e përgjegjësisë së tyre si dhe ngritjen e vazhdueshme dhe adekuatë të kompetencës profesionale të stafit menaxhues dhe teknik, nëpërmjet organizimit të trajnimeve dhe formave tjera të avancimit profesional.

Nga vizita e bërë në linjën hekurudhore Fushë Kosovë-Pejë bashkë me menaxhmentin e kompanisë, komiteti ka vërejtur segmente të caktuara hekurudhore nevojën e ndërhyrjes urgjente dhe ka nxjerrë rekomandimet për Bordin e Drejtorëve të HK-së. Bordi me kohë ka marrë vendimet për sanimin e këtyre rreziqeve potenciale si dhe ka kërkuar nga menaxhmenti i kompanisë të eliminojë me urgjencë këto rreziqe. Si produkt i saj, më urgjencë është bërë hartimi dhe implementimi i murit para tunelit hekurudhor në fshatin Balcë si edhe janë eliminuar disa pengesa që kanë shkaktuar shikime të pamjaftueshme në disa vendkalimet rrugore në këtë linjë hekurudhore. Saniimi është bërë me kohë në fund të vitit 2009 dhe në mënyrë shumë cilësore. Me këtë janë eliminuar disa rreziqe potenciale për zhvillimin e sigurt të transportit hekurudhor.

Një punë shumë të dobishme dhe profesionale ka kryer edhe komiteti për projekte kapitale. Ky komitet gjatë periudhës nga krijimi e deri më tani ka mbajtur mbi 10 takime të rregullta ku ka shqyrtuar ecurinë e projekteve kapitale në Hekurudhat e Kosovës. Duhet theksuar se një rëndësi të veçantë ky komitet i ka kushtuar fazës së planifikimit të projekteve, përgatitjes dhe mbikëqyrjes gjatë fazes së implemnetimit të tyre. Po ashtu komiteti bashkë edhe me menaxhmentin e kompanisë dhe kryetarin e Bordit të Drejtorëve në disa projekte konkrete ka bërë edhe inspektimin e fazave të ndryshme të këtyre projekteve në terren, ka përcjell



Foto nga takimi i Komitetit të HK-së

punimet, ka biseduar me stafin profesionist të involvuar në këto projekte si dhe interesuar për ecurinë e projekteve.

Është më rëndësi të thuhet se nga disa projekte që janë përcjellur në faza të caktuara, komiteti ka hasur edhe në raste kur implementimi i projekteve është përcjellur me defekte dhe probleme.

P.sh. po përmendim rastin e projekteve konkrete: "Mbulimi dhe rrethimi i kanalit në punëtorinë e vagonëve" dhe "Furnizimi me pajisje testuese për mjete lëvizëse". Këto projekte janë shqyrtuar me kujdes nga komiteti dhe Bordin, në bashkëpunim edhe me menaxhmentin e kompanisë, si dhe është punuar shumë në përmirësimin e cilësisë së tyre.

Në projektin e parë komiteti ka vërejtur një mos bashkëpunim të duhur dhe neglizhencë në fazën e përgatitjes dhe lëshime në fazën e mbikëqyrjes së projektit. Ndërsa në projektin e dytë komiteti ka vërejtur lëshime teknike gjatë hartimit të specifikacionit teknik, dhe me kërkesë të komitetit pas një bashkëpunim të ngushtë me stafin teknik përgjegjës profesional me menaxhmentin është arritur të bëhet përmirësimi i duhur i kësaj faze dhe për efekt, projekti ka rezultuar me një implementim shumë cilësor.

Lidhur me këtë, menaxhmenti i kompanisë ka ngritur përgjegjësitë dhe ka marrë masa adekuate me qëllim të ngritjes dhe përmirësimit të efikasitetit dhe cilësisë në implementim të këtyre projekteve dhe shumë projekteve tjera.

Komiteti për projekte kapitale duke e parë nevojën e një kujdesi dhe mbështetje më të madhe për stafin profesional dhe menax-

hmentin, si dhe në mënyrë që ta mbajë të informuar Bordin e Drejtorëve në lidhje me implementimin e projekteve kapitale, pas çdo takimi nxjerr konkluzionet dhe rregullisht e njofton Bordin e Drejtorëve të HK-së për ecurinë e implementimit të projekteve, për problemet eventuale dhe rekomandon Bordin për marrjen e vendimeve me qëllim të shtimit dhe të efikasitetit të cilësisë në implementimin e projekteve kapitale të kompanisë.

Deri më tani komiteti për projekte kapitale ka bërë rekomandime të shumta për Bordin dhe menaxhmentin e Hekurudhave të Kosovës.

Vlen të përmenden rekomandimet e komitetit për përmirësimin e fazës së planifikimit, përgatitjes dhe zbatimit të projekteve, si: nevoja për hartimin më cilësor të termave të referencës për çdo projekt kur shihet e nevojshme; nevoja që kërkesat nga specifikacionet teknike të bazohen në norma dhe standarde adekuate të BE-së për produkte dhe shërbime; nevoja që cilësia e shërbimeve dhe produkteve të dëshmohet nëpërmjet dokumenteve të cilësisë dhe sigurisë, bazuar në certifikatat adekuate për cilësi dhe konfirmimet të jenë të njohura e të pranura ndërmombtarisht; funksionalizimi më i madh i mbikëqyrjes teknike gjatë realizimit të projekteve të ndërtimit dhe renovimit të infrastrukturës fizike në Hekurudhat e Kosovës, sidomos gjatë ndërtimit dhe renovimit të objekteve.

Nga puna e deritanishme, komiteti ka vërejtur se puna në planifikimin, përgatitjen dhe zbatimin final të projekteve në Hekurudhat e Kosovës në përgjithësi kënaq të priturat,

sidomos kur marrim parasysh specifikën e madhe të projekteve në infrastrukturën hekurudhore.

Mirëpo, edhe përkundër këtij përkushtimi, komiteti vazhdimisht është duke kërkuar nga menaxhmenti nëpërmjet BD që të ngritët edhe më tej niveli i cilësisë së përgatitjes e të gjitha fazave që e përcjellin implementimin e projekteve kapitale, duke filluar nga faza e shtrimit të kërkesës për nevojën e projektit, hartimit të termave të referencës e deri tek mbikëqyrja dhe certifikimi final i atyre projekteve.

Duhet theksuar se një nga problemet kryesore me të cilat përballen hekurudhat në fushën e planifikimit dhe implementimit të projekteve kapitale është vjetërsia e buri-meve njerëzore. Ky problem e ka përcjell dhe po e përcjell HK-në që një kohë të gjatë, duke e kufizuar aftësinë absorbuese të një pjese të stafit si pasojë e zhvillimeve të mëdha tekniko-teknologjike me zhvillimin e hovshëm të teknologjisë informatike. Në këtë drejtim komiteti ka sugjeruar menaxhmentit nëpërmjet Bordit të Drejtorëve të Hekurudhave të Kosovës në ngritjen e vazhdueshme profesionale të stafit nëpërmjet trajnimeve dhe formave tjera të ngritjes profesionale.

Po ashtu, komiteti ka rekomanduar që në mungesë të resurseve dhe përvojës në fusha të caktuara dhe aty ku shihet e domosdoshme, si dhe me qëllim të ruajtjes dhe ngritjes së cilësisë së implementimit të projekteve kapitale të angazhojë sipas nevojës edhe ekspert të jashtëm.

NE DHE NDARJA E KOMPANISË



Besim Asllani
Drejtor i Divizionit Komerical

Duke qenë në dijeni për një kohë relativisht të gjatë rreth faktit se procesi i ndarjes së kompanisë momentale në dy kompani të reja e cila do të jetë i domosdoshëm, ne si divizion komercial ka kohë që kemi filluar të përgatitemi për këtë proces në mënyrë që të zvogëlojmë sadopak vështirësitë e mundshme që do hasim gjatë këtij procesi. Duke marrë për bazë dhe studiuar disa raste të ndryshme qoftë të rajonit apo me larg të cilat kanë kaluar nëpërmjet këtij procesi dhe duke u fokusuar më shumë në vështirësitë operative dhe problemet e ndryshme funksionale që janë krijuar si pasojë e ndarjes midis dy kompanive të reja të krijuara, ne si division komercial se bashku me divizionin e infrastrukturës kemi bërë ndryshimet e nevojshme dhe adaptimet e procedurave të ndryshme në mënyrë që të evitojmë këto vështirësi operative me rastin e operimit të këtyre divizioneve si kompani të reja. Rastet e ndryshme në botë të cilat kanë kaluar nëpërmjet këtij procesi na kanë dëshmuar se pas procesit të ndarjes dhe hapjes së tregut edhe për operatore të tjerë, kusht i domosdoshëm për të mbijetuar dhe për të qenë prezent në treg është ndryshimi i mendësisë operuese nga ajo e një monopoli që kemi pasur deri sot, në mendësinë operuese konkurruese. Ne kemi punuar shumë në këtë drejtim që brenda divizionit komercial të mbjellim një kulturë të re pune dhe menaxhimi në mënyrë që të menaxhojmë më lehtë ndryshimet që do sjell procesi i ndarjes dhe hapja e tregut dhe që të jemi në gjendje qofte si kolektiv apo individ ti bëjmë balle sfidave të ndryshme dhe që vlerat tona të jenë në nivel më kërkesat e tregut. Puna jonë që është bërë qoftë në ngritjen e kohezionit brenda divizionit ne aspektin ndernjësor,

qoftë në qasjen tonë drejt tregut dhe shërbimeve tona që ofrojmë, mua si udhëheqës i këtij divizioni me bën të besoj se ne jemi tërësisht të përgatitur që procesin e ndarjes ta kalojmë me sukses dhe se kompania e re TRANKOS do të ketë një perspektivë të mirë për të ardhmen. Ne kemi arritur tashmë të krijojmë një ide të qartë se e vetmja rrugë e zhvillimit të biznesit tonë dhe ngritjes së transportit hekurudhor është që vlerat tona që bartim me veti duhet ngritur vazhdimisht në drejtim të asaj që secila njësi sado e vogël të jetë duhet ta arrij vet qëndrueshmërinë financiare dhe asnjëherë të mos bie nën këtë nivel. Sidoqoftë sfide e jona e vazhdueshme do të jetë që të mbajmë të gjallë këtë shpirt kompaktësie që është brenda nesh, meqenëse të gjithë ne kemi vlerat tona të ndryshme të cilat i kemi ndërlidhur në atë formë

që të korrim suksese dhe përballojmë sfida të ndryshme në të kaluarën dhe këtë vlerë që kemi krijuar nuk guxojmë ta lëmë të na humb përgjatë rrugës sonë. Duke pasur parasysh se edhe ky proces i ndarjes së kompanisë momentale dhe krijimit të kompanisë së re është vetëm një proces i radhës që bën pjesë në rrugëtimin tonë të gjatë, është me rëndësi ta kemi të qartë se e vetmja gjë e cila ka sjellë sukses çdoherë, është qëndrueshmëria e vlerave dhe parimeve në vazhdimësi duke mos bërë kompromis mes interesit individual dhe interesit të kompanisë por ta lidhim çdoherë interesin tonë me interesin e përgjithshëm të kompanisë. Në të kundërtën e gjithë puna jonë dhe angazhimi ynë do të shuhet për shkak të interesit personal të ndonjërit nga ne.



TAKIMI I KRYESHEFIT EKZEKUTIV TË HEKURUDHAVE TË KOSOVËS ME KLIENTËT E TRANSPORTIT



Ditë më parë Kryeshefi Ekzekutiv i HK-së u takua me klientët e transportit hekurudhor ku në këtë takim morën pjesë kreu i Hekurudhave të Kosovës Z. Xhevat Ramosaj, Drejtori i Departamentit të Financave Z. Sefedin Sefaj, Menaxheri i Transportit Z. Jusuf Hajrizi, Menaxherja e Marketingut Arbesa Mjeku si dhe tre agentët e Marketingut të HK-së. Të ftuar në këtë takim ishin 50 "klientët kyç" të Hekurudhave të Kosovës të cilët gjithmonë janë të mirëseardhur në kompaninë tonë që të diskutohen të gjitha problemet që ata i kanë rreth transportit të mallrave me hekurudhë.

Temë e këtij takimi ishte njoftimi i klientëve tanë kyç në lidhje me ecurit e zhvillimeve në HK, krijimi i mundësive të reja për ofrimin sa më të mirë të shërbimeve për klientët tanë, e gjithashtu në këtë takim klientët patën

mundësin që të shprehin opinionet, vërejtjet dhe kërkesat e tyre në lidhje me transportin me hekurudhë e pastaj të diskutojnë në lidhje me këtë me qëllim që në të ardhmen të kenë sa më pak probleme e të përfitojnë shërbime sa më cilësore.

Duke iu drejtuar pjesëmarrësve të këtij takimi Kryeshefi Ekzekutiv i HK tha se objektivat tona kryesore janë të orientuara që klientëve tanë tu ofrojmë shërbime cilësore.

Mundësitë e transportit përmes hekurudhës në Kosovë janë të limituara duke pasur parasysh kapacitetet tona por kjo nuk do të thotë se ju nuk do të bartni mallin tuaj nga momenti i ngarkimit deri në destinacionin e fundit me kohë, të padëmtuar dhe në sasinë të cilën e keni ngarkuar. Unë mund t'ju garantoj një gjë të tillë dhe ky është edhe qëllimi im, heku-

rudha këto raporte i rregullon në mënyrë decitive me Rregulloret e saja të aprovuara deri më tani dhe unë bëjë përpjekje maksimale që edhe punëtorët tanë në hekurudhë tu përmbahen këtyre Rregulloreve sepse vetëm kështu do tu shmangemi problemeve, por edhe në rastet kur do të ketë probleme saktësisht mundë të definohen shkaqet e tyre. Ne mendojmë që bashkëpunimi me ju të jetë edhe më i madh dhe tu jemi në shërbim në çdo kohë. Kërkojmë që ky bashkëpunim në të ardhmen të jetë edhe më i madh. Shpresoj që cilësia e shërbimeve tona të jetë elementi kyç që ju të zgjidhni hekurudhën për transportin e mallrave tuaja.

Pas përfundimit të fjalës së rastit të Kryeshefit Ekzekutiv fjalën e marrin klientët e pranishëm duke shprehur opinionet si dhe vërejtjet e tyre në lidhje me transportin





hekurudhor.

Luan Pllana në cilësinë e Drejtorit të INA Kosova LLC – Bardhosh, transporton derivate, shprehu kërkesën e tij në lidhje me transportin nga Terminali deri në binarin privat në deponin e tij në Bardhosh duke potencuar nevojën që vagonët në këtë relacion ti vendosen për shkarkim sa më shpejt dhe atë mundësisht menjëherë pas përfundimit të procesit të zhdoganimit në mënyrë që të ketë kohë që shkarkimin ta bëjë para përfundimit të orarit të punës dhe kështu tu ikë shpenzimeve shtesë. Gjithashtu kërkoi që edhe pranimi i vagonëve në stacionin kufitar të jetë në format e parapara me Rregulloret në mënyrë që tu iket keqpërdorimeve të mundshme duke potencuar kontrollin e plumbave industriale dhe të tjerave dhe edhe në rastet kur ndodhin ndërrimet e tyre me arsyet e caktuara të bëhen proceset e rregullta dhe të njoftohet klienti, në këtë rast pranuesi i mallit në mënyrë që tu iket keqinterpretimeve dhe dyshimeve të mundshme.

Fahri Ratkoceri pronar i firmës Standard Benz nga Lypjani thekson të njëjtat probleme pasi që edhe ky zhvillon biznesin e njëjtë dhe ka brengat e njëjta por që ndër të tjera thekson edhe mungesën e azhuritit të hekurudhave në raste të caktuara dhe kjo sipas tij në biznesin që e zhvillon mundë të ketë ndikim shumë të madh dhe përfitimet apo humbjet mundë të maten edhe me minutë duke pasur parasysh lëvizjet e çmimeve në berëzën e derivateve të naftës.

Besim Mehmeti nga Gratis Commerce Mitrovicë kërkon që ti zvogëlohet sasia e limituar e transportit deri në Mitrovicë (me Rregulloren për transport është përcaktuar deri në këtë stacion sasia prej minimum 250 ton) dhe klienti kërkon që mundësisht të ulet ky limit në 200 tonë.

Bedri Hamiti nga AgroKor Prishtinë transporton gjëra ushqimore (kryesisht sheqer). Deklaron se ka bërë një kërkesë për rregullimin e vendëshkarkimit në Terminalin e Mallrave në Miradi duke hapur edhe një dalje nga Terminali dhe me këtë do të lehtësohej edhe manipulimi me kamion gjatë shkarkimit/ngarkimit të mallrave. Gjithashtu kërkon që të asfaltohet apo të betonohet edhe pjesa në mes të binarit dhe pjesës për shkarkim sepse në gjendjen e ekzistuese i shkaktohen dëme në kamion (goma) dhe i vështirësohet ngar-

shtatshëm dhe paketimit të papërshtatshëm të mallit në kontejner në disa raste është e pamundur që një kontejner të shkarkohet për 3 orë.

Përkundër këtyre problemeve të potencuara nga klientët tanë të gjithë mendojnë se hekurudha ofron mundësi të mira për transportin e mallrave të tyre dhe shpresojnë se do të kenë shërbime cilësore.

Për të gjitha vërejtjet dhe opinionet e tyre ata morën përgjigjet nga Kryeshefi Ekzekutiv dhe përfaqësuesit tjerë të HK duke ju premtuar



kimi i mallit në kamion.

Sherif Uka pronar i firmës Onix Gjilan, merret me përpunimin e gurit të granitit dhe mermerit, kryesisht transporton me kontejner. E konsideron të pamjaftueshëm afatin kohor prej 3 orësh për shkarkimin e kamionit në depo. Në mungesë të pirunerëve të për-

klientëve që në të ardhmen hekurudhat do të ju ofrojnë shërbime me të cilat ata do të jenë të kënaqur dhe se për kërkesat dhe vërejtjet e tyre mundë të kontaktojnë kurdoherë dhe në çdo kohë përmes numrit kontaktues dhe në takimet e drejtë për së drejta me te.

PLANI I VEPRIMIT PËR NGRITJEN E SIGURISË NË HEKURUDHAT E KOSOVËS

Siguria e Komunikacionit hekurudhore tradicionalisht ka qenë dhe është e lartë në Hekurudhat e Kosovës, por duhet të punohet që sistematikisht të arrihen standardet për modernizimin e tyre

Divizioni i Infrastrukturës në HK ofron siguri për shërbime të transportit në nivelin sa më të lartë duke u bazuar në gjendjen ekzistuese të infrastrukturës duke vepruar në bazë të kompetencave që dalin nga dispozitat e organizimit dhe sistematizimit. Për qëllim të ngritjes së nivelit të sigurisë në Hekurudhat e Kosovës drejtori i divizionit të infrastrukturës ka nxjerrë planin e veprimit për ngritjen e sigurisë në Hekurudhat e Kosovës.

Funksionimi i këtij sistemi kërkon nivel të lartë të organizimit të punës për lëvizjen e trenave. Zhvillimi i komunikacionit hekurudhor kërkon planifikim real të rendit për lëvizjen e trenave, zbatimin e rregullave dhe udhëzimeve, me të cilat garantohej siguria e komunikacionit.

Hekurudhat e Kosovës disponojnë me 333.4 km linjë hekurudhore dhe gjendja momentale e Infrastrukturës në linjat hekurudhore është 66.7 km që janë të aftësuara për shpejtësi prej 70 km/h (linja Fushë Kosovë – Gurëz dhe Klinë – Pejë), 167.8 km janë të aftësuara për shpejtësi prej 60 km/h (Leshak - Fushë Kosovë dhe Fushë Kosovë – Klinë), 6.7 km janë të aftësuara për shpejtësi prej 50 km/h (Prishtinë- Fushë Kosovë), 21.7 km janë të aftësuara për shpejtësi prej 30 km/h, 21.5 km janë të aftësuara për shpejtësi prej 20 km/h, 50.8 km jashtë përdorimit (Xërxe – Prizren 23 km dhe Bardhosh – Livadhi (Besian) 27.8 km), 11.2 km linjë hekurudhore industriale Bardh - Medvec e cila shfrytëzohet për transport të xehes për Feronikelin – Drenas, 117.2 km binarë nëpër stacione.

Në tërë rrjetin hekurudhor gjinden 233 vendkalime të pa mbrojtura por të shënuara me sinjale vertikale. Në tërë rrjetin hekurudhor gjinden 24 tunele 5 prej të cilëve në grykën e Kaçanikut e të cilët janë në gjetje jo të mirë (shpejtësia e ngadalësuar 20 km/h).

Hekurudhat e Kosovës posedojnë 24 stacione hekurudhore dhe 44 pika të qëndrimit për trena, prej tyre 14 stacione janë të zotëruara me personel ndërsa 7 stacione janë të zotëruara me personel vetëm ditën dhe 3 vende zyrtare - stacione nuk janë të zotëruara me personel.

Hekurudhat e Kosovës janë të pajisura me SS,TT dhe EN, 16 stacione - vende zyrtare janë të pajisura për siguri elektro - energjetike, ku sinjalet kryesore janë në varshmëri me ndërueset dhe pajisjet në vendkalime, 1 stacion është i siguruar vetëm me sinjale ndriçuese – elektrike, ndërsa në 6 stacione nuk janë në

funksion sinjalet kryesore. (Prishtinë, Miradi, Bardh, Drenas, Klinë dhe Pejë), 20 vendkalime janë të siguruar me barriera në mënyrë automatike dhe 3 vendkalime me barriera në mënyrë manuale.

I tërë rrjeti hekurudhor dhe mjetet tërheqëse janë të pajisura me sistemin e komunikimit të radiolidhjeve, 17 stacione janë të pajisura me sistemin e komunikimit të telefonisë.

Të gjitha stacionet e lartë cekura dhe mjetet tërheqëse janë të lidhura me sistemin e komunikimit me radio - lidhje me qendrën koordinuese për lëvizjen e trenave (QKLT). Në QKLT janë të vendosura pajisjet e sistemit – Iskra CTC me të cilat mundësohet dirigjimi dhe rregullimi i komunikacionit nga qendra për 10 + 4 stacione të pjesës veriore.

Këto pajisje do të lëshohen në përdorim pasi që të bëhet pranimi teknik i tërësishëm i tyre. Në Hekurudhat e Kosovës janë ndërmarrë veprimet e caktuara për sigurinë e komunikacionit hekurudhor siç janë në sektorin e komunikacionit.

Siguria e Komunikacionit hekurudhore tradicionalisht është në nivel më të lartë në krahasim me format tjera të transporti, veçanërisht në krahasim me transportin rrugor. Prapë se prapë është e nevojshme të sigurohet, zhvillohet dhe të përparohet nivel i sigurisë së Komunikacionit hekurudhore në rrjetin e HK-ës dhe për këtë në Hekurudhat e Kosovës është hartuar edhe plani i veprimeve që duhet ndërmarr për ngritjen nivelit të sigurisë për vitin 2010 dhe atë:

- Duke e pasur parasysh që vendkalimet e pa mbrojtura paraqesin rrezik permanent për sigurinë e komunikacionit, duhet të kërkohet nga përfaqësuesit e kuvendeve komunale dhe institucioneve nënshkruese të dokumentit që sa më parë të kryhen punët rreth eliminimit të vendkalimeve të pa nevojshme ose sigurimi i tyre të bëhet me barijera, ndërsa vendkalimet e egra të eliminohen në afat sa ma të shkurt.

- Hartimi i Udhëzimit për shkollim të personelit ekzekutiv për vitin 2010 dhe organizimi i shkollimit të personelit ekzekutiv sipas udhëzimit përkatës.

- Mbajtja e provimeve të rregullta periodike për personelin ekzekutiv sipas Rr. 646.

- Mbajtja e rregullt e kontrollimeve mjekësore

- Kontroll viziv dhe komplekse e punës sipas planit paraprak nëpër njësi punuese të punonjëseve në shërbimet ekzekutive.

- Përcjellja permanente e zbatimit të orarit të lëvizjes së trenave dhe rregullshmërisë në

zbatimin e dispozitave të aplikueshme në Hekurudhat e Kosovës.

- Rregullimi i binarëve në linja hekurudhore dhe në stacione me makina "Plaser".

- Furnizimi dhe ndërimi i shinave me koka të harxhuara nëpër kthesa.

- Furnizim dhe ndërimi i traversave të kalbura në linja hekurudhore dhe nëpër ura dhe ndërruese.

- Riparimi i lëshesave në linjën hekurudhore Leshak – Hani Elezit.

- Mirëmbajtja e rregullt dhe eliminimi i deformimeve gjatë temperaturave të larta.

- Furnizimi dhe shpërndarja e "Balastit"

- Furnizimi dhe vendosja e gjeneratorëve nëpër stacione

- Mirëmbajtja e rregullt e stabilimenteve sinjalo - siguruese.

- Mirëmbajtja e stabilimenteve të ndërlidhjeve

- Mirëmbajtja e stabilimenteve të CTC

- Intervenimet për eliminimin e pengesave.

Në marrëdhëniet reciproke të bartësve të sigurisë dhe niveleve të ndryshme hierarkike, fusha e sigurisë i reflektohet infrastrukturës së HK-ës dhe rolit kyçë dhe adekuat të menaxhmentit të HK-ës, dhe rolet adekuate të fushës së biznesit dhe njërive shërbyese në këtë proces. Sistemi i menaxhimit të punëve për sigurinë dhe kontrollin mbi zhvillimin e sigurt të komunikacionit, është përgjegjës për zbatimin e funksioneve të menaxhmentit të HK-ës dhe Menaxhmentit të Divizionit të Infrastrukturës.

Kornizën për sigurimin e kushteve për zhvillimin e sigurt të komunikacionit dhe zhvillimin e sistemit për menaxhimin e sigurisë, përfshijë veprime konkrete të sigurisë, e përbëjnë edhe këto elemente:

- Synimet kualitative dhe kuantitative të Hekurudhave të Kosovës SHA për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e sigurisë, si dhe planet dhe procedurat për mbërritjen e këtyre synimeve;

- Procedurat për të siguruar përshtatjen për teknikën ekzistuese, teknikën e re dhe standardet operative, si dhe procedurat të cilat do të sigurojnë përputhshmëri me standardet dhe kushtet tjera gjatë kohës së shfrytëzimit të pajisjeve dhe operimit:

- Procedurat dhe metodat për vlerësimin e rrezikut, si dhe implementimin e masave për kontrollin e rrezikut në rast të ndërrimit të kushteve të operimit ose për zbatimin e materialeve të reja, dhe rrezikut ndaj infrastrukturës ose operimit.

• **Vështrim nga Divizioni i Infrastrukturës**

PËRFAQËSUESIT E HEKURUDHAVE TË KOSOVËS LOBOJNË NË HEKURUDHAT E FRANCËS PËR ANËTARËSIMIN E TYRE NË UIC (UNIONI NDËRKOMBETAR I HEKURUDHAVE)



Me datë 30.31.05.2010 dhe 01.02.06.2010 një delegacion i Hekurudhat e Kosovës i përbërë me kryesuesin e Bordit të Drejtorëve z. Sejdi Hoxha, Kryeshefi i Ekzekutivit z. Xhevat Ramosaj dhe sekretari i kësaj kompanie z. Ruzhdi Morina vizituan Hekurudhat e Francës (SNCF).

Me datë 31.05.2010 përbërja e delegacionit në fjalë është pritur nga përfaqësuesit e Hekurudhave të Francës z. Pascal Lupo Drejtor Gjeneral Për Mardhënie Ndërkombëtare dhe me bashkëpunëtorët e tij Frederik Bardanet dhe Camille Ranciere ku në këtë takim është diskutuar ngritja e bashkëpunimit në fushën hekurudhore në mes

të këtyre dy vendeve.

Hekurudhat e Kosovës kohëve të fundit kanë arritur progres në plotësimin e standardeve duke i përmbushur ato që nga themelimi i autoritetit rregullator, ndarjen e kompanisë në Infrakos dhe Trainkos dhe studimi i projektit për elektrifikim të linjës së dhjetë hekurudhore, andaj Hekurudhat e Kosovës më këtë akt janë një hap para të plotësimit të standardeve në mënyrë që të bëhet modernizimi i kësaj linje dhe në një të ardhme të afërt të anëtarësohen në International Union of Railways (UIC).

Qëllimi i kësaj vizite ka qenë thellimi i bashkëpunimit në mes të dy vendeve dhe ka qenë një kërkesë e veçantë e lobimit për anëtarësim në International Union of Railways (UIC) në mënyrë që Hekurudhat e Kosovës po vazhdojnë drejt modernizimit duke pasqyruar edhe plotësimin e kushteve që janë të parapara me ligj.

Pas një varg takimesh të njëjtit më datë 01.06.2010 e takuan me Drejtorin Gjeneral të International Union of Railways z. Jean – Pierre Loubinoux ku është folur gjatë për anëtarësimin e Hekurudhave të Kosovës Sh.A në Unionin Evropian të Hekurudhave.



NEWCO FERONIKEL NË DRENAS

KLIENT KYQ I HEKURUDHAVE TË KOSOVËS

Për ta përmbushur këtë pasqyrë të punëve të cilat zhvillohen në stacionin hekurudhor të Drenasit ne vizituam edhe xeheroren Newco Feronikeli në Drenas për të cilën xeherore stacioni i Drenasit organizon transportin me hekurudhë.

Arten Bajrush, Menaxher i Administratës dhe Mardhënjeve me Publikun në këtë kompani deklaroi se nga kompanitë – institucionet prej të cilave Newco Feronikeli ka pasur më së tepërmi përkrahje dhe bashkëpunim të mirë është edhe Hekurudha dhe se e çojmë lartë kontributin e Hekurudhave të Kosovës. Jemi të gatshëm të bashkëpunojmë edhe më tutje duke krijuar një raport shumë të ngushtë bashkëpunimi në mënyrë që në të ardhmen kur të krijohen mundësit teknike dhe tjera “asnjë gram mos të bartet me kamion por vetëm me hekurudhë”, me këtë rast duke shpresuar në funksionimin e tërë rrjetit hekurudhor të Hekurudhave të Kosovës dhe funksionalizimit të vijës veriore dhe hapjes së kufirit me Serbinë.

Në sezonin e dimrit nga miniera e feronikelit në Gllavicë nuk janë bartur sasitë e planifikuara për shkak të të reshurave të mëdha dhe lagështisë e cila ka penguar ngarkimin dhe shkarkimin e xehes. Tani me fillimin e sezonit të verës dhe kur kushtet të jenë më të për-

shtatshme sasia e cila planifikohet të bartet nga Gllavica do të jetë 3500 deri në 4000 ton në ditë deklaroi Musli Ademi Përgjegjës për Transport në Newco Feronikeli. Gjithashtu do të bartet edhe një sasi e konsiderueshme e thëngjillit nga Kastrioti. Sipas parashikimeve brenda 24 orëve për këtë gjigant do të transportohen 4000 ton xehe nga Gllavica, 500 – 700 ton thëngjill nga Kastrioti, në rastet kur do të importohet xehe dhe thëngjill nga Indonezia do të barten afërsisht nga 10.000 ton e do të bartet edhe një numër i kontejnerëve me të cilët do të transportohet masa për elektroda e cila është e nevojshme për procesin e punëve të kësaj kompanie. Sipas përgjegjësve të transportit të kësaj kompanie do të kemi mesatarisht nga 6 trena në ditë të cilët nga stacioni i Drenasit do të manipulojnë për nevojat e Newco Feronikelit. Mardhënjet e mira në mes dy kompanive dhe bashkëpunimi shumë i mirë profesional ka ndikuar që transporti të realizohet pa probleme.

Njëkohësisht vlerësohet lartë edhe bashkëpunimi në mes strukturave të cilat i udhëheqin këto dy kompani dhe në rastet kur paraqitet nevoja krijohen mundësi që transportet të realizohen pa kurrëfar problemesh dhe pengesash.

Bashkëpunimi i mirë nuk mungon edhe me sektorët tjerë të Hekurudhave të Kosovës kur është e nevojshme të bëhen riparimet e binarit industrial dhe vagonëve të kompanisë Newco Feronikeli.

Gjithashtu edhe me rastin e ngjarjeve të jashtëzakonshme mirëkuptimi dhe ndihma reciproke për tu përballuar situata dhe për tu zhvilluar procesi pa pengesa është jashtëzakonisht në nivel të lartë dhe kështu situatat tejkalohen pa ndikim në procesin e punëve në këto kompani.

Në fund shpresojmë që ky bashkëpunim dhe ky nivel i mardhënjeve reciproke të vazhdojë dhe të mbahet në shkallën më të lartë e me këtë të krijohen përfitime të dy anshme.

nevojshme të bëhen riparimet e binarit industrial dhe vagonëve të kompanisë Newco Feronikeli. Gjithashtu edhe me rastin e ngjarjeve të jashtëzakonshme mirëkuptimi dhe ndihma reciproke për tu përballuar situata dhe për tu zhvilluar procesi pa pengesa është jashtëzakonisht në nivel të lartë dhe kështu situatat tejkalohen pa ndikim në procesin e punëve në këto kompani.

Në fund shpresojmë që ky bashkëpunim dhe ky nivel i mardhënjeve reciproke të vazhdojë dhe të mbahet në shkallën më të lartë e me këtë të krijohen përfitime të dy anshme.



HISTORIKU I STACIONIT HEKURUDHOR TË DRENASIT

Binari hekurudhor, Fushë Kosovë – Pejë është ndërtuar në vitin 1936 dhe përgjatë kësaj vije e cila urë lidhëse përmes hekurudhës në të dy pjesët vitale të shtetit të Kosovës – Rrafshin e Dukagjinit me Rrafshin e Kosovës e me këtë përmes Rrafshit të Dukagjinit edhe Anadrininë përmes vijës hekurudhore Klinë – Prizren e cila është ndërtuar në vitin 1963. Përgjatë kësaj linje kanë funksionuar një numër i konsiderueshëm i stacioneve hekurudhore për një kohë të gjatë të cilat kanë përbërë një pjesë të konsiderueshme të punëve prej të cilave hekurudhat kanë krijuar të hyra si nga transporti i mallrave ashtu edhe nga transporti i udhëtarëve.

Sipas të dhënave deri me ndërtimin e këtij binari qendër e rajonit të Drenicës ka qenë Komorani i cili ka qenë i përqendruar në rrugën magjistrale e cila ka lidhë kryeqendrën e Kosovës me Rrafshin e Dukagjinit – Pejën, Deçanin dhe Gjakovën. Pas ndërtimit të binarit në vitin 1936 qendra e rajonit të Drenicës kalon në Drenas (ish Glllogoc) dhe prej atëherë edhe ky stacion ka një rëndësi të veçantë duke përmbushur kërkesat e popullatës së Drenicës për transportin e udhëtarëve dhe të mallrave. Rëndësia e stacionit të Drenasit ka qenë e madhe para lufte, gjithashtu edhe sot është pothuajse stacioni kryesor prej nga sigurohen të hyrat e konsiderueshme për Hekurudhat e Kosovës duke e renditur tani për tani menjëherë pas stacionit hekurudhor në Miradi.

Sot, në këtë stacion sipas fjalëve të përcjellësit të trenave Franë Nrecës qarkullojnë mesatarisht nga 18 trena brenda 12 orëve. Transporti i udhëtarëve ka qarkullim prej dy trenave të cilët nisën nga Prishtina për në Pejë – treni 4201 i cili nga Prishtina nisat në orën 07:50 dhe treni 761 që vazhdon në orën 16:30 dhe trenat nga Peja nr. 76 në orën 05:30 dhe treni 4200 në orën 11:10. Për udhëtarët e kësaj qendre treni ka qenë dhe është gjithnjë një mjet transporti i cili ka përmbushur kërkesat e tyre si nga baza materiale, ashtu edhe për nga komoditeti që ofron treni, sepse stacioni ndodhet në mes të qendrës dhe udhëtarët me mjaftë lehtësi mund ta përdorin për udhëtim. Raportet e krijuara në mes të personelit dhe udhëtarëve janë shumë të mira dhe tani nuk ka vështirësi për komunikim dhe bashkëpunimi i cili është në nivelin më të lartë të mundshëm. Duke marrë parasysh numrin e udhëtarëve që qarkullojnë brenda ditës nëpër këtë stacion problem të konsiderueshëm paraqet salla e pritjes

sepse kapacitetet e sallës ekzistuese janë shumë të vogla për t'i plotësuar kërkesat e udhëtarëve dhe njëra prej vërejtjeve të udhëtarëve dhe personelit është pikërisht në këtë çështje. Por kur merret parasysh gjendja e popullatës së këtij rajoni dhe mundësit e tyre materiale hekurudha prapëseprapë është një mekanizëm shumë i rëndësishëm i transportit për këtë pjesë.

Transporti i mallrave në këtë stacion gjithashtu zënë vend të rëndësishëm. Përmes këtij stacioni realizohet transporti i mallrave për nevojat e NewCo Feronikelit dhe kështu brenda një ndërrimi në këtë stacion manipulohet mesatarisht me nga 18 trena për nevojat e kësaj kompanie me të cilën Hekurudhat e Kosovës kanë kontratë për transport të mallrave. Kjo kompani realizon transport nga miniera e xehes së feronikelit në Gllavicë – Medvec dhe nga Kastrioti ku bartet një sasi e konsiderueshme e thëngjillit, gjithashtu edhe nga stacioni i Vollkovës për Feronikelin bartet xehe, thëngjill dhe kontejner nga Indonezia. Bashkëpunimi i personelit dhe përgjegjësve për transport të Kompanisë dhe atyre të Feronikelit, sipas përcjellësit Franë Nreci janë të shkëlqyera dhe në asnjë mënyrë nuk ka pasur probleme. Numri i madh i vagonëve me të cilët manipulohet brenda një ndërrimi në këtë stacion është i madh dhe sipas përcjellësit të stacionit Franë Nreci ky stacion ka nevojë të ketë numër më të madh të punëtorëve. Stacioni i Drenasit ka punë por edhe disa probleme të cilat janë të nevojshme për tu zgjidhur, sepse kur punohet mundë edhe të gabohet: po të ngritësh një peshë të rëndë mundë ta ngarkosh dhe ta dëmtosh vetë veten dhe dëmet mundë të jenë njerëzore dhe materiale, mirëpo këtë peshë nëse do ta ndajmë në mënyrë proporcionale dëmet do të jenë më të vogla. Duke marrë parasysh që hekurudha është një mekanizëm i transportit që kërkon përpikëri në veprime në mënyrë që të zhvillohet komunikacioni i sigurt, atëherë ky stacion ka nevojë që të ketë numër më të madh të punëtorëve që manipulimet në këtë stacion që ta krijojmë një bazë të mirë të zhvillimit e komunikacionit të sigurt. Kjo do të bazohet në kërkesat dhe nevojën e klientëve për shtim të sasive të mallrave që do të transportohen përmes këtij stacioni.





HISTORIKU DHE RËNDËSIA E OPERIMIT ME TRENA

Nga mesi i shekullit XVIII, transporti i udhëtarëve dhe mallrave bëhej me mjete të ndryshme tërheqëse kryesisht me kafshe, mirëpo në atë periudhë kohore kishte filluar zhvillimi industrial, ky zhvillim i shtyri shkencëtarët që të gjejnë një modul për mjetet të cilat do ta lehtësojnë transportin e udhëtarëve dhe të mallrave.

Për herë të parë në Angli u arrit që të konstruktoret linja e parë hekurudhore me 15 shtator 1830 në relacioni Liverpool- Manchester. Ky revolucion industrial bëri një kthesë të madhe në historikun e transportit të udhëtarëve dhe mallrave, disa dekada më vonë perandoria Osmane filloj ndërtimin e linjës hekurudhore Shkup-Mitrovicë, kjo u realizua në vitin 1874. Fillimisht kjo linje është shfrytëzuar për nevojat e perandorisë Osmane për transport ushtarak dhe të xehes nga minierat e Trepçës, ndërsa më vonë filloj të përdoret edhe për nevojat e transporti publik të udhëtarëve dhe mallrave.

Rritja dhe zhvillimi ekonomik i hekurudhave të Kosovës ka qenë varësisht prej rrethanave historike të vendit, por kulminacioni i zhvillimit ka qenë nga viti 1974 e deri në vitin 1989.

Në këtë periudhë kohore Hekurudhat e Kosovës kanë arritur të jenë pjesë integrale e hekurudhave evropiane. Ku shtriheshin me 333 km linjë hekurudhore dhe mbulonte shumicën e qendrave të Kosovës, si dhe kishte lidhje ndërkombëtare nga jugu me Maqedoninë në veri dhe veri-lindje me Serbinë.

Në këto vite HK-së parkun e mjete lëvizëse në pronësi të vete posedonin:

32 lokomotiva dizel-elektrike, 15 trena motorik, 70 vagonë të udhëtarëve, 1489 vagonë të mallrave. Me këto kapacitete arritën të realizojnë transport brenda viti 3 milion udhëtarë dhe 3 milion ton mallra të ndryshme, e gjithë kjo arrihej sepse në këtë periudhë kohore trenat e rregullt të udhëtarëve brenda 24 orëve kanë qarkul-

luar prej tyre 18 trena të cilët ishin vendor dhe 13 trena ndërkombëtare. Treni i cili lidhte Kosovën me Evropën perëndimore ishte treni i ashtuquajtur Akropolis i cili operonte Athinë-Munih. Ndërsa, në transportin e mallrave brenda 24 orëve qarkulloni 38 trena, prej tyre 25 trena vendor dhe 13 trena ndërkombëtare të mallrave.

Ndërsa, zhvillimi në hekurudhat e vendit tonë nisën në vitin 1990, atëherë kur Kosovës iu morë autonomia dhunshëm nga Serbia, dhe ky fat i keq e përcolli edhe kompaninë tonë dhe qysh nga ky vit e deri në mbarimin e luftës në vitin 1999, në mënyrë permanente është bërë shkatërrimi dhe vjedhja dërmuese e pasurisë dhe mjeteve lëvizëse nga pushuesit Serb.

Sipas Menaxherit aktual të transportit Jusuf Hajrizi i cili potencoi se menjëherë mbas luftës në Kosovë kompania u gjend në një situatë shumë të mjerueshme, ku kishin mbetur vetëm 3 lokomotiva, dhe 9 vagon të mallrave edhe këto jo në gjendje të mirë teknike, në të njëjtën kohë kompania është marrë nën kontroll nga ana e forcave të KFOR-it, e cila forcë ka menaxhuar kompaninë që transportuan kryesisht mallra për nevoja të tyre deri në vitin 2002, nga ky vit kompania i është dorëzuar administratës civile të UNMIK-ut dhe nga kjo kohë kompania ka filluar të menaxhohet nga stafi civil. Me këtë rast, kompania është regjistruar me emrin Hekurudhat e UNMIK-ut pran institucioneve përgjegjëse dhe ka filluar të transportoj mallra edhe për tregun komercial.

Pas vitit 2006 në krye me Kryeshefin e Ekzekutivit z. Xhevat Ramosaj si bartës i të gjitha proceseve kompania e ka ndërruar statusin e saj ligjor duke e transformuar nga Hekurudhat e UNMIK-ut në Hekurudhat e Kosovës e cila është for-

muar si Shoqëri Aksionare. Andaj, sipas menaxherit të transportit Jusuf Hajrizi i cili theksoi nga ky vit kemi shënuar një ngritje të transporti të mallrave për 20% nga viti në vit.

Falë angazhimit të punonjësve të HK-së dhe miqve ndërkombëtare me ndihmat më mjetet lëvizëse të përdorura të cilat i dhuruan si donacione për HK-në ishin 5 lokomotiva 4 boshtore nga Gjermania, 4 lokomotiva 6 boshtore nga Norvegjia, 2 lokomotiva 4 boshtore nga Franca, 3 trena motorik një lokomotivë manovruese dhe 20 vagonë të mallrave nga Italia, 10 vagonë të udhëtarëve nga Suedia dhe së fundi me 10 gusht 2009, ishin 7 vagonë të udhëtarëve nga Austria.

Këto donacione nga shtetet e ndryshme dhe ndihma e vazhdueshme e qeverisë së Kosovës, si dhe insistimi i faktorit ndërkombëtar bëri të mundur që të lëshohet treni i parë i udhëtarëve, treni i "Lëvizjes së Lirë" në vitin 2000, me qëllim që të lehtësoj transportin e udhëtarëve kryesisht të komuniteteve pakicë në relacioni Hani Elezit -Fushë Kosovë-Leshak. Linja tjetër është hapur në vitin 2006, është linja e vetëm ndërkombëtare e cila lidhe Prishtinën me Shkupin, ku operojnë dy trena në ditë. Andaj në tetor të vitit 2007 është lëshuar treni komercial në relacionin Prishtinë – Pejë i cili operon brenda ditës me katër trena.

Me gjithë ato pengesa që na krijohen për shkak të mungesës së mjaftueshme dhe vjetërisë së mjeteve lëvizëse ne do të vazhdojmë t'i mbajmë këto linja të transporti të udhëtarëve, ku brenda vitit udhëtojnë afër 400.000 udhëtarë. Përpjesitë e transportit të udhëtarëve më tren janë duke pas parasysh shërbimet e lira krahasuar me transportet tjera, po ashtu edhe transportet e mallrave. Andaj, kjo na shtyn që në të ardhme t'i japim prioritet zhvillimit dhe zgjerimit të këtyre shërbimeve.

Si nevojë e domosdoshme për ngritjen e cilësisë së shërbimeve që ofrojnë Hekurudhat e Kosovës, u mbajt një trajnim gjasthtë ditor me temat Sjelljet ndaj Konsumatorëve dhe Marrëdhëniet me Publikun

MBAHET TRAJNIMI ME PUNËTORET E HK-SË

Ditë me parë u shpërndanë certifikatat në mënyrë solemne nga Kryeshefi i Ekzekutivit z. Xhevat Ramosaj

Në Hekurudhat e Kosovës mbahen trajnimet periodike, mirëpo ky trajnim ishte i rëndësishë së veçantë duke pasur parasysh iniciativën e marrë për ngritjen e cilësisë së shërbimit të punëtorëve në temat: "Sjellja ndaj Konsumatorëve" dhe "Marrëdhëniet me Publikun". Në këtë trajnim pjesëmarrës ishin punëtorët që drejtpërdrejt janë të lidhur me pasagjerët dhe klientët e HK-së duke mos e përfshirë edhe personelin tjetër ku numri i përfituesve arriti në këtë trajnim në 32 veta.

Ky trajnim ka pasur karakter shkollimi në


titujt në fjalë në mënyrë që të ngritët cilësia e menaxhimit të këtij personeli përkatësisht në rastet kur kemi të bëjmë me pasagjerët dhe klientët të cilët i kanë zgjedhur shërbimet e Hekurudhës së Kosovës.

Ana përmbajtësore e këtij trajnimi kishte të bëjë me çështjet më thelbësore deri në nivelin më të lartë të menaxhimit të punës. Në këtë kontekst në temën e parë e cila është ligjërues ka qenë me temë: Ç'është konsumatori, çfarë kuptimi kanë sjelljet e tij", "Etika e punës", "Sjellja ndaj konsumatorëve", Karakteristikat e sjelljes ndaj konsumatorit", "Sjellja ndaj

konsumatorëve në mënyrë të organizuar", "Sjellja ndaj konsumatorëve individual" etj. Pas kësaj ligjëruese vazhdoi pjesa e dytë me temën: "Marrëdhëniet me Publikun" ku në këtë ligjëratë përfituan pjesëmarrësit e njëjtë që janë përfshirë me tema të veçanta si: "komunikimi edukativ me publikun", "aspekti organizativ si dhe menaxhimi me publikun", "Si t'i krijojmë vlerat e kompanisë për publikun", etj.

Në fund të këtij trajnimi të suksesshëm 6 ditor të gjithë pjesëmarrësit u pajisen me certifikata për këto dy tema të cilat janë ligjërues.






Blerina Leku
Vizitë familjare
Relacioni:
Drenas – Pejë

Udhëtoj me tren dhe gjithmonë ndjehem komod dhe e sigurt.


Unë jamë shumë e kënaqur që treni qarkullon në këtë linjë dhe shfrytëzoj trenin për ta vizituar familjen time. Udhëtoj me tren dhe gjithmonë ndjehem komod dhe e sigurt. Nuk kam probleme me personelin dhe zakonisht me tren udhëtoj katër deri në pesë herë në muaj. Po të kishte orare më të shpeshta besoj se do ta shfrytëzoja trenin edhe më shpesh. Kur kemi nevojë ne na ndihmojnë edhe personeli dhe kështu udhëtimi me tren na bëhet më i përshtatshëm dhe më i sigurt. Në disa raste në stacionet ku mungojnë peronët për hyrje dhe zbritje nga treni për disa kategori të udhëtarëve është pakë më e vështirë por shpresojmë se edhe këtë problem do ta zgjidhë hekurudha.



Merita Leku
Punëtore
Relacioni: Domanek - Klinë

PO TË KETË TRENA MË SHUMË DO TË PLOTSOHESHIN NEVOJAT E UDHËTARËVE

Në këtë relacion udhëtoj gjashtë here në javë. E shfrytëzoj trenin për shkuarje dhe ardhje në punë dhe deri më tani nuk më ka ndodhur të mungoj ose të vonohem për shkak të vonësës së trenit. Udhëtimi është mjaft i mirë, komod dhe i sigurt. Gjithashtu edhe çmimi është i lirë. Do të kishte qenë mirë që në këtë realcion të shtohen numrat e trenave dhe oraret më të shpeshta ditore në mënyrë që tu përshtatet kategorive të ndryshme të udhëtarëve si punëtorëve në sektorë të ndryshëm, nxënësve, studentëve dhe të tjerëve të cilët do ta shfrytëzonin për ti përmbushur nevojat e tyre personale kur udhëtojnë në qytetet si Pejë, Klinën, Drenasin dhe Prishtinën.



Z. Endrit Mustafaj
Student
Relacioni: Klinë – Prishtinë

PËR STUDENT BENEFICIONET JANË TË MIRËSEARDHURA – PAGUAJM 50% MË LIRË

Jam student dhe udhëtoi në relacionin Klinë – Prishtinë si dhe anasjelltas e shfrytëzoj trenin së paku dy here në javë. Për mua si student treni është shumë i përshtatshëm. E shfrytëzoj për shkuarje dhe ardhje në studime sidomos gjatë ditëve të vikendit si të Premteve dhe të Hënave zakonisht. Në këto ditë për shkak të frekuencës së madhe të udhëtarëve krijohet ngarkesë e madhe me udhëtarë dhe kur në qarkullim janë dy vagon nuk janë të mjaftueshëm për të udhëtuar komod. Gjithashtu edhe numri i trenave në këtë relacion është i pakët. Jam i pajisur me kartelë identifikuese për udhëtim me tren dhe kjo na e bënë edhe më të lirë udhëtimin që për bugjetin tonë si student është mjaft mirë.



Z. Nezir Gashi
Pensioner
Relacioni: Klinë – Prishtinë

PËR MUA UDHTIMI ME TREN ËSHTË SHUMË I PËRSHTATSHËM

Udhëtimi me tren për mua është shumë i përshtatshëm dhe atraktiv. Ndjehem komod dhe udhëtoj lirshëm, nuk ndjej lodhje dhe ndjehem komfor në udhëtim. Deri më tani nuk kam përjetuar asnjë problem apo pakënaqësi. Komunikoj mjaftë mirë me personelin dhe gjithëherë kemi mirëkuptim në mes nesh. Do të ishte mirë që të ketë trena

edhe më tepër në këtë relacion sepse nevoja në këtë linjë për më tepër trena është mjaft e madhe. Për ne të moshuarit edhe çmimi i udhëtimit është i lirë pasi që paguaj vetëm 50 % nga çmimi i biletës së rregullt



Mr.sc. Bedri Millaku - phd kandidat
Shërbyes civil në qeverinë e Kosovës

Qarkullimi i Trenit në këtë relacion ofron mundësi më të mira udhëtimi për shumë kategori të udhëtarëve

Jam udhëtar i rregullt në relacionin Ujmirë – Prishtinë. Udhëtoj çdo ditë pune në këtë relacion. Ajo që më ka shtyrë të jap opinionin tim për udhëtimin me tren është se që nga dita e parë e qarkullimit të trenit në relacionin Prishtinë - Pejë kam udhëtuar në këtë relacion. Se sa është i rëndësishëm qarkullimi i trenit në këtë relacion lirisht po them se ka lidhur qytetin e Pejës me Prishtinën, por më e rëndësishme është që treni në këtë relacion ka lidhur pjesët rurale (fshatrat) me pjesën e qyteteve të Kosovës, pra pjesët më të izoluar por edhe popullatën më të dëmtuar nga lufta e fundit në Kosovë të cilët me vështirësi të shumta më par kanë komunikuar me qytetet Prishtinën dhe Pejën. Aq e rëndësishme është funksionimi i kësaj vije hekurudhore për nxënësit, studentet, veteranet dhe invalidët e luftës së UÇK-së, familjarët e dëshmorëve, pensionistët dhe shtresat më të atakuar me gjendjen sociale përfitojnë nga beneficionet të cilat i ofron hekurudha. Kjo është për tu lavdëruar. Vlen të ceket se qarkullimi i trenit është i sakët e kam fjalën për orarin. Personeli është i afërt dhe komunikativ me udhëtarin. Ne udhëtarët kemi kërkesa që numri i trenave në këtë relacion të shtohet, sidomos është kërkesë që mundësisht të shtohet numri i vagonëve në këta trena që janë në qarkullim, sepse numri i udhëtarëve është i madh dhe kështu me gjendjen ekzistuese me këtë numër të vagonëve në qarkullim ulet komforti dhe komoditeti i udhëtimit. Mbajtja e pastrisë në trena është në nivel. Pasi që jam udhëtar i rregullt në këtë relacion po e vërej nevojën që nëpër ato stacione ku nuk ka salla të pritjes për udhëtar dhe peron për hyrje dhe dalje nga treni udhëtarët po kanë vështirësi. Eliminimi i këtyre problemeve do ta lehtësonte udhëtimin me tren sidomos te moshat e vjetra dhe fëmijët. Ne punëtorët e qeverisë të cilët udhëtojmë me tren propozojmë se në qoftë se paguhet udhëtimi nga qeveria që të behet marrëveshje me Hekurudhat e Kosovës.

HEKURUDHAT E KOSOVËS MENDOJNË EDHE PËR TË MITURIT

Menaxhmenti i lartë mori vendim që t'i gëzoi nxënësit e shkollës fillore 'Hasan Prishtina' me një eskursion (shëtitje) me tren nëpër Kosovë



Shukrije Ukshini nxënëse e klasës së V2 theksoi se për mua udhëtimi ishte një eksperiencë shumë e bukur në jetën time, e kam të vështirë të përshkruaj kënaqësinë që pata në këtë shëtitje. Këtë e them se në sytë tanë shkëlqente bukuria mjedisore dhe natyrore ku nuk e kemi pasur rastin që asnjëherë që ta shikojmë e tërë atë gjelbërim gjatë këtij udhëtimi me tren. Një falënderim i veçantë i takon Kompanisë së Hekurudhave të Kosovës që na mundësoi këtë shëtitje, gjithashtu i falënderoi edhe për shërbimin cilësor që na kanë ofruar.

Nxënësi i klasës së pestë Muhamed Troshupa

theksoi se asnjëherë nuk kishte pasur rastin që të udhëtoi me tren dhe ky udhëtim ishte tejet i kënaqshëm për të, duke pas parasysh akomodimin dhe shërbimin e HK-së. Unë nuk kam pasur rastin më herët që të udhëtoi me tren por tani e realizova dhe jam shumë i lumtur, i falënderoi Hekurudhat e Kosovës për realizimin e kësaj shëtitje.

Me datë 12.05.2010 menaxhmenti i lartë mori vendim që t'i gëzoi nxënësit e shkollës fillore 'Hasan Prishtina' me një eskursion (shëtitje) me tren nëpër Kosovë

Më kërkesën e drejtorisë së shkollës fillore

"Hasan Prishtina" Hekurudhat e Kosovës Sh.A kanë organizuar një shëtitje për nder të nxënësve të klasave V1, V2, V3, V4, V5 ku numri i tyre ishte mbi 200 nxënës, kjo gjeneratë e nxënësve patën rastin të shëtisin dhe të kënaqen në një udhëtim relaksues në relacionin Prishtinë – Fushë Kosovë – Pejë dhe anasjelltas.

Pas realizimit të këtij eskursion Kryeshefi i Ekzekutivit të Hekurudhave të Kosovës z. Xhevat Ramosaj potencoi se Hekurudhat e Kosovës janë në shërbim të qytetarëve të Kosovës në linjat e rregullta ku gravitojnë Hekurudhat e Kosovës, mirëpo do të bëjmë përjashtime edhe për të pasur vozitje të lira me tren për të ngritur shërbimet ndaj qytetareve të Kosovës e posaçërisht ndaj nxënësve.

Fatime Kelmendi, pedagoge në shkollën fillore Hasan Prishtina falënderon Kryeshefin e Hekurudhave të Kosovës që dha mundësinë për të realizuar këtë vozitje të lirë duke theksuar se është një interes i veçantë për nxënësit që e njohën për së afërmi sektorin e Hekurudhave të Kosovës dhe që të kënaqen me këtë shëtitje.

Shukrije Ukshini nxënëse e klasës së V2 theksoi se për mua udhëtimi ishte një eksperiencë shumë e bukur në jetën time, e kam të vështirë të përshkruaj kënaqësinë që pata në këtë shëtitje. Këtë e them se në sytë tanë shkëlqente bukuria mjedisore dhe natyrore ku nuk e kemi pasur rastin që asnjëherë që ta shikojmë e tërë atë gjelbërim gjatë këtij udhëtimi me tren. Një falënderim i veçantë i takon Kompanisë së Hekurudhave të Kosovës që na mundësoi këtë shëtitje, gjithashtu i falënderoi edhe për shërbimin cilësor që na kanë ofruar.



HEKURUDHAT E KOSOVËS SËRISH PËRKRAHIN HANDIKOS-in

Menaxhmenti i Hekurudhave të Kosovës Sh.A përveç vitevetë tjera që ka mbështetur materialisht HANDIKOS-in, ajo prapë ka marrë vendim për të sponzoruar një aktivitet sportiv me rastin jubilar të 16 vjetorit të themelimit të degës së HANDIKOS-it në Vushtrri



Në këtë aktivitet sportiv në ndarjen e çmimeve për ekipet fituese mori pjesë Shefi i Zyrës për Informim i Hekurudhave të Kosovës Sh.A z. Refet Çitaku duke iu drejtuar opinionit publik: Hekurudhat e Kosovës urojnë 16 vjetorin e themelimit të degës së HANDIKOS-it të Vushtrrisë, si dhe përgëzon angazhimin e këtij aktiviteti, sepse ky aktivitet sportiv ka ndikuar në zgjimin dhe pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në tërë territorin e Kosovës në aktivitetet sportive të basketbollit me karroca, po ashtu ky gjest human do të mbetet shëmbëlltëre për donator të tjerë duke iu mundësuar kësaj shoqërie aftësimin dhe përgatitjen e këtij lloj sporti më qëllim të integritimit në shoqërinë e përditshme.

Këtë turnir e ka përkrahur Hekurudha e Kosovës ShA me qëllim që kjo shoqëri (me aftësi të kufizuara) të integrohet në këto aktivitete sportive si dhe në aktivitetet e tjera

që do të mundën t'i realizojnë HANDIKOS-i. Andaj, Hekurudhat e Kosovës nuk hezitojnë që të aprovojnë projekte të tilla duke pas parasysh që në Kosovë gjinden një numër i madh i personave me aftësi të kufizuara të moshave të ndryshme, e në përgjithësi të rinjtë nga moshë 20 deri në moshë 40 vjeçar të cilët munden të merren me një aktivitet të tillë. HK-ja ka ndarë një shumë të mjetëve ku janë përfshirë nevojat e realizimit të këtij aktiviteti.

Me anë të një projekti të degës së HANDIKOS-it në Vushtrri e cila kishte karakter sportiv për zhvillimin e një turniri, Menaxhmenti i Hekurudhave të Kosovës SH.A, ka mbështetur financiarisht duke e bërë këtë aktivitet tradicional për

HANDIKOS-in. I njëjti turnir ishte mbajtur edhe në vitin e kaluar me datën 12.09.2009 duke filluar prej orës 11:00 në palestrën e sportit 'PRISHTINA PROBASKET' dhe ishte realizuar në mënyrë të suksesshme, ndërsa edhe këtë vit Hekurudhat e Kosovës kontribuan për realizimin e këtij projekti. Ky turnir me karroca i financuar HK-ja është mbajtur në palestrën sportive "Jeton Terrstena (Toti)" në Vushtrri më datë 10.07.2010 e cila filloi në ora 10:00 ku marrin pjesë të gjitha degët e HANDIKOS-it në të gjitha komunat e Kosovës si: Prishtina, Gjlani, Ferizaj, Vushtrria, Gjakova, Mitrovica, Prizreni, Peja, Podujeva etj.



Aktivitetet sportive të punëtorëve të Hekurudhave të Kosovës Sha

AKTIVITETET SPORTIVE FRESKIM PËR PUNËTORET E HK-së

Duke e pas parasysh se zhvillimi i aktiviteteve sportive brenda kompanisë ka ndikim të shumëfishtë pozitiv atëherë në mënyrë të organizuar janë rezervuar dy termine në sallën sportive "Herta" në Fushë Kosovë. Në këtë sallë çdo të Hëne dhe të Enjte për një orë zhvillohen lojë në futboll të vogël nga punëtorët e Hekurudhave të Kosovës. Aty krijohet një atmosferë sportive

dhe është një mundësi për t'u relaksuar si dhe për t'u shoqëruar larg obligimeve dhe detyrave zyrtare ditore.

Këtë vit në kuadër të këtyre termineve janë organizuar edhe turnirë në mini ligën e krijuar brenda HK-ve (gjashtë ekipe) dhe të njëjtat kanë zhvilluar edhe ndeshje për kupë. Aktualisht pas përfundimit të sezonit pranverorë gjendja nga ndeshjet e zhvilluara

është prezantuar më poshtë, kurse në kupë sistemin fituese është ekipi " Lokomotiva".

Aktiviteti i ynë sportiv – futboll të vogël nuk është kufizuar vetëm në kuadër të kolektivit, që nga viti 2009 Hekurudhat e Kosovës janë anëtare të FSPK-së (Federatës Sportive të Punëtorëve të Kosovës). Kjo Federatë ka organizuar ligën e FSPK-së ku Hekurudhat e Kosovës kanë arritur një sukses solid.

TABELA GRUPI "A"

	EKIPET	loja	flore	barazime	Humbje	g.ave	+/-	piket
	PTK	8	8	0	0	30:10	+20	24
	POLICIA	8	7	0	1	46:17	+21	21
	KEK	8	6	0	2	32:14	+18	18
	FSK	8	5	0	3	36:21	+15	15
	REBKO	8	5	0	4	21:19	+2	12
	HEKURUDHA	8	3	0	5	21:33	+12	9
	B.EKONOMIKE	8	2	0	6	19:35	-16	6
	UJESJELLES	8	1	0	7	15:42	-27	3
	IPKO	8	1	0	7	15:42	-27	3

TABELA GRUPI "B"

	EKIPET	loja	flore	barazime	Humbje	g.ave	+/-	piket
	DOGANA	8	6	2	0	26:7	+19	20
	T E B	8	6	1	1	26:11	+15	19
	A N P	8	4	2	2	22:17	+5	14
	B Q K	8	4	1	3	20:11	+9	13
	ASSEOC	8	4	0	4	21	-9	12
	M P B	8	3	0	4	21:26	-5	9
	DUKAGJINI	8	3	0	5	12:31	+19	4
	KUJTESA	7	4	0	3	17:14	+3	12 *
	B P B	7	1	1	5	15:24	-9	3 *

TABELA/REZULTATET

Rezultatet – xhiroja e I

Takimet	Rezultatet	Data	Ora
Lokomotiva – Administrata	(4 – 0)	29/04/2010	(18:00)
Elektro – Treni	(3 – 0)	03/05/2010	(20:00)
Mirëmbajtja – Komunikacioni	(2 – 5)	06/05/2010	(18:00)

Rezultatet – xhiroja e II

Takimet	Rezultatet	Data	Ora
Administrata – Komunikacioni	(7 – 7)	10/05/2010	(20:00)
Treni – Mirëmbajtja	(4 – 2)	13/05/2010	(18:00)
Lokomotiva – Elektro	(2 – 0)	17/05/2010	(20:00)

Rezultatet – xhiroja e III

Takimet	Rezultate	Data	Ora
Elektro – Administrata	(4 – 2)	20/05/2010	(18:00)
Mirëmbajtja – Lokomotiva	(2 – 1)	24/05/2010	(20:00)
Komunikacioni – Treni	(3 – 2)	27/05/2010	(18:00)

Rezultatet – xhiroja e IV


Takimet	Rezultate	Data	Ora
Lokomotiva – Komunikacioni	(0 – 1)	31/05/2010	(20:00)
Administrata – Treni	(1 – 0)	03/06/2010	(18:00)
Elektro – Mirëmbajtja	(1 – 0)	07/06/2010	(20:00)

Rezultatet – xhiroja e V

Takimet	Rezultatet	Data	Ora
Mirëmbajtja – Administrata		10/06/2010	(18:00)
Komunikacioni – Elektro		14/06/2010	(20:00)
Treni – Lokomotiva		17/06/2010	(18:00)

TABELA

Nr	Ekipi	Pikët	Lojë	Fitoret	Barazimet	Humbjet	Golat-Sh	Golat-P	Gol-dallimi
1	Komunikacioni	10	4	3	1	0	16	11	+5
2	Elektro	9	4	3	0	1	8	4	+4
3	Lokomotiva	6	4	2	0	2	7	3	+4
4	Administrata	4	4	1	1	2	10	15	+5
5	Treni	3	4	1	0	3	6	9	+3
6	Mirëmbajtja	3	4	1	0	3	6	11	+5



Ta ruajm ambientin



Hekurudhat e Kosovës Sh.A
Kosovske Železnice D.D
Kosovo Railways J.S.C

info: 038 536 758
marketing@kosovorailway.com



Shijone natyrën duke udhëtuar



Hekurudhat e Kosovës Sh.A
Kosovske Železnice D.D
Kosovo Railways J.S.C

info: 038 536 758
www.kosovorailway.com